

DITARI MUJOR

MARS 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

MINISTRJA PIRDENI PREZANTON VIZIONIN E DRAFT-STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR REFORMËN NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Ministrja Pirdeni zhvilloi një takim konsultativ me përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues të shoqërisë civile, partnerë ndërkombëtarë, me akademikë dhe grupe të ndryshme interesi për të diskutuar Draft-Strategjinë Ndërsëktoriale për Reformën në Administratën Publike 2024-2030. Pirdeni renditi risitë që sjell SNRAP 2024-2030 u shpreh se, Reforma në Administratën Publike, pjesë e Grup-kapitujve "Themeloret", mbart rëndësi kritike në përparimin e procesit të negociatave, si shtyllë thelbësore për mirëfunksionimin e shtetit dhe si parakusht për avancimin e agjendës evropiane. SNRAP 2024-2030 është e përbërë nga pesë qëllime politikash përmes të cilave synohet të jetëzohet vizioni i strategjisë, përkatësisht: Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave; Shërbimi Civil dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore; Ofrimi i Shërbimeve dhe Digjitalizimi; Organizimi, Llogaridhënia dhe Mbikëqyrja e Administratës; Administrata e Gjellbër Publike. SNRAP 2024-2030 përmban 16 objektiva specifike; 76 masa; 2 plane veprimi (2024-2026; 2027-2030); mbi 20 institucione qendrore përgjegjëse; 10 institucione të pavarura përgjegjëse.



DY FITUESIT E ÇMIMIT TË MADH "KARLSPREIS" ZBARKOJNË NË TIRANË, BASHKOHEN NË NJË DIALOG MIDIS BREZAVE MBI PERSPEKTIVAT E EVROPËS 2030

Në një event unik për rajonin e Ballkanit, Fondacioni "Karlspreis", i lidhur me çmimin prestigjioz ndërkombëtar "Karlspreis – Karli i Madh" (International Charlemagne Prize of Aachen), një nga nderimet më të larta evropiane për më shumë se shtatë dekada, mbledhi në Tiranë laureatë të këtij çmimi së bashku me liderë të rinj nga Shqipëria dhe pjesa tjetër e Evropës. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin së bashku me Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët si dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë mirëpritën eventin e nivelit të lartë "NextGEN Voices for Europe (Zërat e gjeneratës së re për Evropën) të orientuar drejt të rinjve dhe bashkëpunimit evropian, të organizuar në bashkëpunim me Fondacionin Rinor Karlspreis. Në Tiranë, Kryeministri Edi Rama, dy laureatët e çmimit "Karlspreis", Z.Martin Schulz, ish-President i Parlamentit Evropian dhe Znj.Veronika Tsepalo, përfaqësuese e opozitës bjelloruse, Dr. Jürgen Linden, kryetar i bordit drejtues i "International Charlemagne Prize" përshëndetën fituesit e Çmimit të Rinisë Karlspreis, si dhe të rinjtë shqiptarë duke shkruar kufijtë në një dialog pa doreza dhe të thelluar midis brezave, pa mbi të ardhmen e Evropës në vitin 2030.



ZËRAT E GJENERATËS SË RE PËR EVROPËN: NGA COPËZIMI TE FORCA – EKONOMIA DHE SIGURIA NË FOKUS

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin së bashku me Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Agjencinë Kombëtare të Rinisë mirëpritën ditën e dytë të eventit të nivelit të lartë "NextGEN Voices for Europe (Zërat e gjeneratës së re për Evropën) të orientuar drejt të rinjve dhe bashkëpunimit evropian, të organizuar në bashkëpunim me Fondacionin Rinor Karlspreis. Në kuadër të diskutimeve mbi sfidat dhe perspektivat e kontinentit Evropian, u mbajt paneli i titulluar "Nga Copëzimi te Forca: Ekonomia dhe Siguria në Evropë në Fokus". Diskutimi u hap me fjalimin e Z. Rene van der Linden, President Nderi i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, i cili theksoi rëndësinë e bashkëpunimit për të adresuar sfidat ekonomike dhe të sigurisë në Evropë.



Ministër i Shtetit për Administratën
Publike dhe Antikorrupsionin
Adea Pirdeni



mapa.gov.al
adeapirdeni



APirdeni

8 MARS, MINISTRJA PIRDENI: MBI 55% E KOLEGËVE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE JANË GRA

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni gjatë një takimi me gratë dhe vajzat në Pallatin e Kongreseve, u shpreh se mbi 55% e kolegëve në institucionet e administratës janë gra, jo si rezultat i kuotave apo i ndonjë skeme favorizuese, por sepse ato kanë treguar se i përkasin misionit të shërbimit publik. Gjithashtu, ministrja Pirdeni theksoi se përfshirja e grave në vendimmarrje nuk është një rastësi apo një nevojë për protagonizëm, por një zgjedhje e qëllimshme për të ndërtuar institucione të forta dhe për të jetësuar vlerat që shoqëria shqiptare aspiro.



SHQIPËRIA MERR PJESË ZYRTARISHT SI SHTET VËZHGUES NË RRJETIN EVROPIAN TË ADMINISTRATËS PUBLIKE (EUPAN)



Shqipëria ka marrë pjesë për herë të parë me statusin zyrtar të shtetit vëzhgues në Rrjetin Evropian të Administratës Publike (EUPAN). Në takimin e mbajtur më 13-14 mars në Varshavë të Polonisë, në kuadër të Presidencës Polake të Këshillit të BE-së, delegacioni shqiptar së bashku me përfaqësues të vendeve anëtare dhe kandidate të BE-së, diskutoi mbi sfidat dhe prioritetet e administratave publike evropiane, me fokus në: Etikën; Përdorimin e inteligjencës artificiale dhe inovacionin digjital; Administratën e gjelbër; Digjitalizimin e shërbimeve publike; Zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin publik. Delegacioni shqiptar përfaqësohej nga Znj. Fotjona Taçe, Shefe e Kabinetit pranë MAPA, Znj. Enkela Dudushi, Drejtore e Përgjithshme e Departamentit të Administratës Publike dhe Z. Eneid Kërçini, Drejtor i Programeve të Reformës në Administratën Publike, DAP.

STRASBURG, MINISTRJA PIRDENI NDJEK PUNIMET E SEANCËS PLENARE TË GRECO-S, SHQIPËRIA PËRMBUK MBI 75% TË REKOMANDIMEVE

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, ishte e pranishme në Strasburg të Francës nga data 17 deri më 19 mars 2025, ku ndoqi nga afër punimet e seancës së 99-të plenare të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), organ i Këshillit të Evropës. Gjatë kësaj seance, u miratua Raporti i Raundit të Pestë të Vlerësimit për "Parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e integritetit në qeverisjen qendrore dhe institucionet e zbatimit të ligjit". Sipas raportit të GRECO-s, Shqipëria ka shënuar progres të rëndësishëm në forcimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit, pasi ka adresuar mbi 75% të rekomandimeve për qeverisjen qendrore dhe institucionet e zbatimit të ligjit. Presidenti i GRECO-s, Z. David Meyer, e vlerësoi si të shkëlqyer rezultatin e Shqipërisë, duke theksuar progresin e ndjeshëm të vendit në forcimin e mekanizmave kundër korrupsionit.



SHQIPËRIA KALON ME SUKSES RAUNDIN E 5-TË TË VLERËSIMIT TË GRECO-S PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT, PIRDENI: NJË TJETËR DETYRË SHTËPIE E KRYER PËR PROCESIN E NEGOCIATAVE!



Shqipëria shënon progres të rëndësishëm në forcimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit. Sipas raportit të fundit të GRECO-s (Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit), vendi ynë ka adresuar mbi 75% të rekomandimeve për qeverisjen qendrore dhe institucionet e zbatimit të ligjit. Raporti i Raundit të pestë të Vlerësimit të GRECO-s, miratuar në Strasburg, trajtoi "Parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e integritetit në qeverisjen qendrore dhe institucionet e zbatimit të ligjit". Rezultatet e raportit u diskutuan në eventin ku morën pjesë Kryeministri i Shqipërisë, Z. Edi Rama, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, Ministri i Brendshëm, Z. Ervin Hoxha, si dhe Z. Gianluca Esposito, Drejtor i Përgjithshëm për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit në Këshillin e Europës, etj. Ministria Pirdeni theksoi gjatë fjalës se ky vlerësim nuk është thjeshtë një tregues teknik, por një dëshmi konkrete e hapave që kemi ndërmarrë për të forcur transparencën, llogaridhënien dhe integritetin e institucioneve tona. Shqipërisë iu lanë për zbatim 24 rekomandime, nga këto rekomandime, 18 janë realizuar plotësisht, ndërkohë që pjesa tjetër janë pjesërisht të zbatuara dhe vetëm një mbetet ende për t'u zbatuar.